



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e III-të për vitin 2012, e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 05.4.2012 dhe vazhduar më 30.04.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Habib Mustafa, Habibe Gërzhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërzhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani. Kurse mungonin: Abdullah Halimi, Syzana Sylja dhe Gani Imeri, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të medieve të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Ferit Idrizi - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke iu referuar dorëheqjes që e ka paraqitur, njoftoi se ka paraqitur edhe shkresën tjetër, përmes së cilës njofton se e ka tërhequr dorëheqjen deri në një interpretim juridik, pasi që kryetari i komunës ka parashtruar kërkesë për interpretim juridik për kryesuesin e kuvendit dhe për të gjithë anëtarët e kuvendit që njëkohësisht punojnë edhe si shërbyes civil.

Pastaj falënderoi të gjithë anëtarët e kuvendit, zyrën e kuvendit dhe zyrën e informimit për punën e shkëlqyeshme, pasi që është hera e dytë që Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë shpallet kuvendi më i mirë në nivel të Kosovës. Gjithashtu uroi edhe kryetarin e komunës, pasi që Komuna e Vushtrrisë është shpërblyer edhe për shërbime cilësore.

Në vazhdim pasi që hapi debatin lidhur me rendin e ditës, propozoi që në të ndryshme të futen:

- a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfrytëzim të mjeteve të fondit stimulues të USAID-DEM-it, në vlerë prej 25.000 \$;

- b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfrytëzim të mjeteve të fondit stimulues të USAID-DEM-it, në vlerë prej 45.000 \$.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së përgëzoi shpërblimin e fituar të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë nga një institucion prestigjioz, dhe shtoi se këto dy shpërblime u morën nën udhëheqjen e kryesuesit, por tani është zbehur dhe është vënë në lajthitje autoriteti i institucionit, pasi që kryesuesi ka paraqitur dorëheqje dhe pa ndryshuar rrethanat të cilat i ka paraqitur në arsyetimin e dorëheqjes e ka tërhequr dorëheqjen. Prandaj Grupi parlamentar i LDK-së e vlerëson si një veprim joserioz, dhe propozon që kryesuesi të mos e kryesojë seancën e kuvendit, deri sa të vjen përgjigjja nga ministria kompetente, kurse punimet e kuvendit të vazhdojnë, duke e udhëhequr seancën e kuvendit anëtarin më i moshuar i kuvendit, sepse nëse nuk vepron kështu, Grupi parlamentar i LDK-së nuk do të qëndron në sallë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së paraqiti vërejtje pasi që seanca e KK-së është thirrur në mënyrë të kundërligjshme, sepse edhe shtyrja e mbajtjes së seancës në fjalë ka shkel Rregulloren për punën e kuvendit të komunës. Gjithashtu tha se është thirrur seanca e KK-së pa u njoftuar siç duhet anëtarët e kuvendit lidhur me dorëheqjen e kryesuesit. Pastaj shtoi se interpretimi është i gatshëm, pasi që nuk mundet kryesuesi t'i ushtrojë dy pozita në të njëjtën kohë, prandaj tërheqja e dorëheqjes së kryesuesit është një lojë dhe kuvendit i bie një hije e keqe. Në fund tha se Grupi parlamentar i AAK-së nuk do të jetë pjesëmarrës në këtë seancë, prandaj duhet të thirret një seancë tjetër e ligjshme, duke kërkuar zbatim të ligjit.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së e vlerëson lartë punën e kryesuesit të kuvendit, Ferit Idrizi, ku si rrjedhojë e punës së mirë dhe efikase në këtë kuvend për të dytin vit radhazi merr shpërblimin për punën dhe transparencën e kuvendit nga USAID-i, prandaj Grupi parlamentar i PDK-së ka marrë vendim që dorëheqjen e kryesuesit aktual të mos e pranojë, dhe shtoi se dorëheqja e kryesuesit nuk është e rregulluar me LVL-në, Udhëzimin Administrativ dhe as me Statutin e Komunës. Në fund tha se Grupi parlamentar i PDK-së nuk do ta pranojë dorëheqjen e kryesuesit derisa të vjen një interpretim juridik nga ministria përkatëse për kryesuesin dhe për anëtarët tjerë të kuvendit, që njëkohësisht punojnë edhe si shërbyes civil.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se angazhimet për punë të suksesshme të kuvendit kanë qenë të të gjithë anëtarëve të kuvendit, duke u ngritur mbi interesat madhore të qytetarëve dhe në shumë momente mbi interesat e ngushta partiake. Pastaj lidhur me rastin konkret për këtë seancë, por edhe për shumë seanca tjera ka qenë edhe më herët me Rregullore të UNMIK-ut, edhe tani me ligjet e Qeverisë së Kosovës se udhëheqësit e sektorëve, apo të departamenteve nuk mundën me qenë edhe në organet politike dhe shtoi se kjo mbledhje është enigmatike me vet ndryshimin e datës së kësaj mbledhjeje pa pëlqimin e kuvendit, dhe e njëjta nuk mund të emërtohet si e jashtëzakonshme, por as si e rregullt, pasi që Rregullorja e punës së kuvendit parashikon mbajtjen e mbledhjeve të KK-së në të enjten e fundit të çdo muaji. Gjithashtu tha se nga këto zhvillime që po ndodhin, shtrohet çështja se të gjitha ato vendime që janë marrë dhe këto vendime që kishin me u marrë, prandaj pyeti se a janë nënshkruar nga një person i autorizuar ligjor, pra kryesuesi aktual a e ka legjitimitetin e duhur dhe bazën ligjore në këtë drejtim, dhe në rastin konkret deri sa nuk ka qëndrime të qarta, Grupi parlamentar i AAK-së nuk do të marrë pjesë në këtë seancë, sikur qysh nuk ka marrë pjesë edhe në rastet tjera kur janë marrë vendime të kundërligjshme. Në fund kërkoi nga përfaqësuesi i MAPL-së që gjërat t'i përcjell siç duhet në ministri, në mënyrë që të qartësohet roli i shërbyesit civil, por edhe roli i përfaqësuesit politik i institucioneve të ndryshme dhe shtoi se në këtë rast

për hir të drejtësisë do të kërkohet edhe në instancat më të larta, qoftë edhe në Gjykatën Kushtetuese, vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë të akteve që janë nxjerrë dhe që do të nxirren, si dhe veprimeve të fundit që kanë ndodhur.

Nysret Gërxhaliu, anëtar i kuvendit- tha se është në kompetencën e çdo subjekti politik të vendosë se si do të punojë, veprojë dhe si do të merr vendime, prandaj e përkrah Grupin parlamentar të PDK-së, dhe kërkoi që rendi i ditës i proceduar nga KPF-ja të përkrahët dhe të vazhdojnë punimet e KK-së. Në fund përgëzoi kuvendin e komunës për marrjen e shpërblimit për transparencë dhe punë efikase nga një organizatë prestigjioze.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se kryesuesi i kuvendit zyrtarisht ka paraqitur dorëheqje, mirëpo zyrtarisht edhe e ka tërhequr dorëheqjen, pastaj tha se nëse sipas ligjit kryesuesi duhet të jepë dorëheqje pasi që njëkohësisht është shërbyes civil jashtë komunës, pyeti se a është dashtë që edhe shërbyesit tjerë civil që punojnë jashtë komunës, e që njëkohësisht janë anëtarë të kuvendit të japin dorëheqje dhe shtoi se në cilësinë e kryetarit të komunës ka kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe MAP-ja për kryesuesin dhe për të gjithë anëtarët e kuvendit që janë njëkohësisht shërbyes civilë jashtë komunës.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se jemi të njoftuar përmes medieve dhe ueb-faqes zyrtare të komunës për dorëheqjen e kryesuesit, dhe duke iu referuar përmbajtjes së dorëheqjes, pyeti pse tani kryesuesi po mund ta realizojë detyrën me sukses. Pastaj tha se nuk është pozitë e anëtarit të kuvendit e ngjashme me pozitën e kryesuesit të kuvendit, sepse asnjëri prej anëtarëve të kuvendit që njëkohësisht është shërbyes civil jashtë komunës nuk është në pozicion që të nënshkruajë ndonjë akt në emër të kuvendit, por të gjitha aktet e kuvendit të komunës i nënshkruan kryesuesi i kuvendit, prandaj kjo paraqet konflikt të interesit. Mandej tha se akti i dorëheqjes së kryesuesit të kuvendit është një akt moral dhe i drejtë, mirëpo tërheqja e dorëheqjes nuk i shërben pozitës së subjektit në pushtet, dhe nga kjo po nënkuptohet që nuk po i ipet përparësi as PDK-së dhe as komunës, por po i ipet përparësi interesave më të vogla se PDK-ja, dhe shtoi se interesi i komunës është mbi interesin e çdo subjekti politik. Gjithashtu tha se çdo tërheqje e dorëheqjes është lojë me kuvendin dhe ulje e vlerës së kuvendit, partive politike dhe zbatimit të ligjit në komunë. Në fund kërkoi që të vazhdojnë punimet e seancës së KK-së duke e kryesuar seancën anëtari më i moshuar i kuvendit.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke iu referuar interpretimeve të ndryshme nga anëtarët e kuvendit, kërkoi që të pritet interpretimi juridik nga ministria kompetente të cilës iu ka adresuar kërkesa për çështjen në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me dallimin në mes të anëtarëve të kuvendit dhe kryesuesit që janë njëkohësisht edhe shërbyes civilë jashtë komunës, tha se edhe anëtarët e kuvendit edhe pse nuk nënshkruajnë, janë vendimmarrës.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se në bazë të informatave të tij, kërkesën që e ka adresuar kryetari i komunës për interpretimin ligjor vetëm për 4 anëtarë të kuvendit, por nuk ka kërkuar interpretim ligjor për kryesuesin e kuvendit në cilësinë e anëtarit të kuvendit.

Idriz Muzaqi, drejtor i Drejtorisë për Administratë- duke iu referuar dorëheqjes së ofruar nga kryesuesi, tha se çështja e dorëheqjes nuk është akt ligjor, por është akt moral. Pastaj propozoi që të pritet interpretimi ligjor dhe pastaj të zbatohet ashtu siç vjen interpretimi ligjor.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me 17 vota "për", 1 "abstenim", (kurse 7 anëtarë të kuvendit nga LDK-ja dhe 7 anëtarë të kuvendit nga AAK-ja lëshuan sallën e kuvendit duke mos marrë pjesë në votimin e rendit të ditës dhe as në punimet e mëtejme të kuvendit) miratoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese, si dhe raporti i punës së kryetarit të komunës (ekzekutivit) për vitin 2011.
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSB-së për vitin 2011.
4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin e brendshëm të administratës dhe përshkrimin e vendeve të punës (shqyrtimi i parë).
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për entitetet publike dhe jopublike (shqyrtimi i parë).
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 01.Nr 17/12, të datës 26.01.2012.
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim pa kompensim të pronës së paluajtshme në pronësi të komunës.
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rrënimin e objektit të komunës, rregullimin e hapësirës dhe ndërtimin e shtatores "Hasan Prishtina".
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e Bordit Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese urbane (për herë të dytë).
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin e Bordit Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese urbane.
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për anulimin e Vendimit të kuvendit të komunës.
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për kryerjen e shërbimeve me auto-merimangë.
13. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfrytëzim të mjeteve të fondit stimulues të USAID-DEMI, në shumën prej 25.000 \$.
 - b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfrytëzim të mjeteve të fondit stimulues të USAID-DEMI, në shumën prej 45.000 \$.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet me 17 vota "për", 1 "abstenim" procesverbali i mbledhjes së KK-së, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese, si dhe raporti i punës së kryetarit të komunës (ekzekutivit) për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSB-së për vitin 2011.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me raportin e punës në fjalë, tha se duke u mbështetur në: Planin e Punës për vitin 2011; Planin e investimeve të aprovuara më 2010, për vitin 2011; Bashkëpunimin dhe përkrahjen e Qeverisë së Kosovës, të Komisionit Evropian, të USAID-it, të OSBE-së; Partecipimin e qytetarëve dhe të donatorëve të tjerë, janë realizuar pothuajse të gjitha projektet e planifikuara për vitin 2011 (të cilat janë të pasqyruara në raport), si dhe shumë projekte të tjera jashtë planifikimit me interes jetik për të gjithë qytetarët e komunës. Kurse shuma e tërësishme e buxhetit të komunës për vitin 2011 ishte 13.071.484,51 €, ndërsa pagesat (shpenzimet) janë realizuar me 12.365.620 € ose 94.60 %. Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2011 janë realizuar mbi planifikimin për 4.34 % dhe më tepër se në vitin 2010 për 15.82%.

Në vitin 2011 janë nënshkruar 192 kontrata publike në Drejtorinë e Prokurimit, përmes zbatimit të procedurave të prokurimit dhe ka pasë:

Mjete të zotuar: 5. 504.705,32 €; Mjete të kontraktuara: 4.840.959,44 €; Diferenca : 663.745,88 €.

Gjithashtu janë realizuar 151 projekte kapitale, të vogla ose më të mëdha, pa përfshirë këtu disa prej projekteve të financuara nga disa donatorë, prej të cilave :

36 rrugë të shtruara në asfalt në gjatësi 69.426 m;

24 rrugë të shtruara në kubëza me gjatësi 5.853 m;

64 projekte të tjera (të evidentuara të gjitha në raport);

Në vazhdim përmendi disa prej projekteve tjera të rëndësishme që janë realizuar ose kanë filluar të realizohen gjatë vitit të kaluar, e që shumica prej tyre janë donacione:

Ka filluar të ndërtohet fabrika për trajtimin e ujit të pijshëm në Balinc, e cila pritet të përfundojë në vitin e ardhshëm (donacion i Qeverisë), për t'u zgjidhur një prej problemeve më elementare dhe jetike për banorët e komunës;

Ka filluar të ndërtohet objekti i ri i komunës (donacion i Komisionit Evropian);

Është zhvendosur dhe është ndërtuar tregu i ri i qytetit;

Ka përfunduar objekti i ri i QKMF-së në Vushtrri (donacion i Komisionit Evropian);

Është në përfundim e sipër ndërtimi i urës në Prelluzhë (donacion i Qeverisë);

Është aftësuar stacioni i pompimit për ujitje në Balinc;

Ka filluar restaurimi i Kalasë së Qytetit (donacion i USAID-it);

Ka filluar restaurimi i Muzeut të Qytetit (ish-shtëpia e Mahmut Agë Giinollit);

Kanë përfunduar punimet në kullën e Azem dhe Shotë Galicës;

Është ndërtuar shkolla në Bukosh dhe ka filluar të ndërtohet shkolla në fshatin Zhilivodë;

Është rindërtuar parku i qytetit (investim i përbashkët i USAID-it dhe komunës);

Ka filluar të ndërtohet shëtitë e përgjatë lumenjve të "Tërstenës" dhe "Silnicës" (investim i USAID-it);

Janë ndërtuar lokalet ndihmëse për pajisjet e zjarrfikësve (investim i përbashkët i Tirolit të Austrisë dhe komunës);

Mandej tha se janë bërë angazhime për një administratë të reformuar, duke bërë ndryshime të nevojshme në Statut dhe Organogram të Komunës, në rregullore të ndryshme për krijim dhe funksionim të avancuar të infrastrukturës ligjore, të administratës komunale dhe duke përdorur këtu edhe ndihmën e organizatës DEMI të USAID-it dhe ECLOS-it, të Komisionit Evropian, e cila ka rezultuar me një menaxhim më të mirë të financave, të prokurimit dhe shërbime më të mira për të gjithë qytetarët.

Tutje tha se papunësia është një dukuri brengosëse në Kosovë, pra edhe në komunën tonë, megjithatë, fakti që Komuna e Vushtrrisë ka mjaft tokë bujqësore mundëson që shumë familje tona të krijojnë të hyra dhe të mira materiale nga punët bujqësore ose ato të blegtorisë. Pastaj fillimi i punimeve në Fabrikën e Llamkosit, ku sipas kontratës me AKP-në, kontraktori është i obliguar që të punësojë 437 punëtorë, e që në realitet është duke e bërë këtë, si dhe hapja e bizneseve të reja, të vogla ose të mesme e kanë zbut sadopak papunësinë në komunë. Në vazhdim tha se hapja e Qendrës së Biznesit në komunë dhe krijimi i mundësisë nga qeveria që të regjistrohen bizneset pa bërë pagesa për regjistrimin e tyre, është një tjetër rrethanë lehtësuese për bizneset tona. Kurse në vitin 2011 me qëllim të rregullimit urban, për tri zona të qytetit u miratuan planet rregullative nga kuvendi i komunës. Gjithashtu tha se identifikimi dhe menaxhimi efikas i pronave komunale ishte gjatë vitit të kaluar, por është edhe gjatë këtij viti objektiv dhe angazhim i kadastrit, i cili ka filluar të japë rezultatet e para.

Puna në mësimdhënie për ngritje të cilësisë në mësim, është realizuar duke investuar në krijimin e hapësirave të reja shkollore, renovime të atyre ekzistuese, transportit të nxënësve, angazhimit më të madh për disiplinë në punë si dhe përmirësimin të ndjeshëm të pozitës materiale të punëtorëve të arsimit. Hapja e

shkollës së muzikës si një nevojë e kahmotshme e kulturës dhe arsimit për komunën, më në fund u realizua në vitin e kaluar.

Po ashtu tha se Komuna e Vushtrisë ka arrit që të avancojë vlerat kulturore duke organizuar e mbajtur aktivitete tashmë tradicionale të kulturës, ndërsa gjetja e donatorëve për restaurim të monumenteve të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe ngritja e atyre të rejave që shënojnë luftën e lavdishme të UÇK-së, nga planifikimet e kuvendit, janë suksese fillestare që e kthejnë imazhin e qytetit të vjetër me një histori krenarie për gjithë banorët e komunës dhe më gjerë. Pastaj tha se objektet e reja të ndërtuara në fshatra dhe qytet, për funksionim më efektiv të QKMF-së, kanë krijuar kushte më të mira për të pasur mbrojtje më efikase të shëndetit të qytetarëve. Gjithashtu tha se investimet e komunës, por edhe të donatorëve në rritjen e kapaciteteve teknike në Njësinë e Zjarrfikësve kanë ndikuar ndjeshëm në efektshmërinë e punës së tyre si në menaxhimin e zjarreve gjatë verës së vitit të kaluar, por edhe aktiviteteve vjetore të tyre dhe krahas realizimit të këtyre projekteve ose fillimit të realizimit të tyre, është paraqitur edhe ndonjë dobësi e rastit, ndër të cilët përmendi rastin kur kuvendi ka ndarë parcelat për ndërtimin e objekteve të banimit për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe për familjet me gjendje të rëndë materiale, mirëpo përkundër angazhimeve të komunës, projekti akoma nuk ka mundur të realizohet. Ndërsa në kuadër të projekteve të planifikuara ka dështuar realizimi i blerjes së aparatit të rëntgenit për objektin e ri të QKMF-së, i cili është investim nga granti qeveritar dhe për të cilin janë duke u zhvilluar procedurat gjyqësore ndaj kompanisë që nuk ka arrit ta realizojë kontratën me komunën. Mandej tha se në këtë vit komuna ka paguar shuma të konsiderueshme të mjeteve, për shkak të dënimeve gjyqësore, për punë të keqmenaxhuara në të kaluarën, ose si rezultat i korrupsionit të mundshëm nëpër prokurori dhe gjykata, të cilat mund të jenë të ndërlidhura edhe me persona fizikë të interesave brenda ose jashtë komunës. Ndërkaq një prej synimeve që nuk është realizuar, e që ka qenë me prioritet është edhe hapja e mundësive të realizimit të projekteve të ndryshme me interes për komunën dhe bizneset, me ndihmën e partneritetit publiko-privat, por pengesë për këtë deri tani ka qenë edhe mungesa e favorshme e infrastrukturës ligjore, pasi që siç dihet, tani është aprovuar Ligji i Partneritetit Publiko-Privat, i cili krijon kushte më të favorshme, por megjithatë ky ligj nuk është i lehtë për zbatim.

Në fund falënderoi të gjithë donatorët e jashtëm, të cilët ndihmuan në realizimin e projekteve me interes për të gjithë qytetarët e komunës, si:

USAID-in për investime të rëndësishme dhe me vlerë për të gjithë qytetarët, si dhe Organizatën Implementuese të Projekteve të USAID-it –DEMI-it, që me punën e tyre të përkushtuar, nëpërmes kryetares së kësaj organizate-Ginka Kapitanova, ekspertëve të tyre e në veçanti të Besim Kurtit, të cilët me projektet e tyre ndihmuan në ngritjen e performancës së administratës komunale dhe e mbështetën Komunën e Vushtrisë edhe me investime dhe implementime të projekteve për këtë qëllim;

Komisionin Evropian, i cili bëri investime të rëndësishme dhe me vlerë për komunën si dhe Organizata për Implementim- ECLC (Bashkëpunimi Evropian për Komuna më të Fuqishme), e cila kontribuoi në ngritje të performancës komunale;

Zyrën Civile Ndërkombëtare dhe OSBE-në, për bashkëpunim me shumë interes, me investimet për pajisjen me inventar të arkivës dhe bibliotekës komunale;

KFOR-in për punën e madhe në krijimin e sigurisë për të gjithë qytetarët dhe investimet në infrastrukturë, në meremetim të hapësirave shkollore në komunë, duke falënderuar në veçanti Gjeneralin Byhler për kontributin e veçantë që ka dhënë për komunën tonë dhe LMT sllovene që me angazhimin dhe përkushtimin e tyre kanë ndihmuar në shumë fusha, përveç asaj të sigurisë;

Qeverinë e Kosovës, që me investimet shtesë për komunën tonë, kontribuoi që të përmirësohet jeta e qytetarëve tanë, e në veçanti me investimet për fabrikën e ujit, si dhe urën e Prelluzhës dhe infrastrukturën rrugore.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar dorëheqjes së kryesuesit, tha se çështja e dorëheqjes është problem personal i individit, përderisa nuk zyrtarizohet

dorëheqja. Pastaj tha se është shqetësuese nëse dorëheqja në fjalë është një fasadë sa për të mbuluar problemet tjera kardinale të Komunës së Vushtrrisë, me ç'rast gjykatat po merren edhe me njerëzit që punojnë në komunë, prandaj edhe ne po fërkohe mi me njerëzit që janë zhytur në llumin e kimit deri në fyt. Në vazhdim duke iu referuar raportit të punës të kryetarit të komunës, tha se kryetari në asnjë moment nuk e përmendi që në Komunën e Vushtrrisë hetuesia është duke e bërë punën e vet. Pastaj tha se edhe pse ka përparime të mëdha në Komunën e Vushtrrisë, në mesin e këtyre zhvillimeve ka edhe ngecje, devijime, sabotime dhe plaçkë, por që kryetari nuk e përmendi askund, prandaj kërkoi që të distancohe mi nga keqpërdoruesit, dhe si shembull të keqpërdorimit përmendi edhe ndërrimin e emrit të shkollës "Latif Berisha". Mandej duke iu referuar faqes së tretë të raportit në fjalë, tha se nuk është dashtë të paraqiten në raport aktivitetet e kryetarit, pasi që janë detyra obligative që i përshkruan vendi i punës. Po ashtu tha se nuk kanë mbetur shumë hapësira gjelbëruese në Vushtrri, duke shtuar se edhe parku aktual është i mbushur me mbeturina. Kurse lidhur me zvogëlimin e numrit të ndërtimeve pa leje, pyeti kur janë zvogëluar ndërtimet pa leje, dhe rikujtoi që e ka ngritur në kuvend çështjen e ndërtimeve pa leje në tokën e bukës në rrugën e cila të çon në fshatin Bukosh, mirëpo nuk është ndërmarrë asgjë dhe shtoi se në asnjë rast kryetari i komunës nuk ka intervenuar për rrënimin e ndonjë ndërtimi pa leje në Komunën e Vushtrrisë. Prandaj tha se kjo çështje nuk është dashtë të figurojë në raport, përderisa ndërtimet pa leje e kanë gllabëruar qytetin dhe tokat e bukës. Kurse lidhur me skemën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, tha se për mallra dhe shërbime janë mbi 1 milion euro, ndërsa investimet kapitale janë vetëm 4 milionë euro, prandaj kjo paraqet një anakronizëm që nuk shkon në favor të statistikave çfarë do të duhej të ishin. Po ashtu tha se shpenzimet nga humbjet gjyqësore janë marramendëse në shumën mbi 59.000 € brenda një viti, prandaj pyeti ku është avokati i komunës, dhe shtoi se në këtë rast duhet ndëshkuar drejtorët e drejtorive, të cilët nuk e kanë interpretuar ligjin siç duhet. Lidhur me faqen nr. 13, ku thuhet se mungon furnizimi me rëntgen, tha se po të vizitohen ordinancat private, të gjitha kanë rëntgen, kurse Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale nuk është në gjendje të sigurojë material rezervë për nevojat e qytetarëve, ndërsa për çdo ditë me dhjetëra qytetarë kanë nevojë për fotografime, pasi që janë të sëmurë nga tuberkulozi, nga sëmundjet tjera të rrezikshme dhe kanë fraktura të ndryshme, dhe nga gjendja nënkuptohet se këtu ka kabotazh, pasi që dikush ka krijuar lidhje me ordinancat private, dhe si rezultat i kësaj, kërkoi nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që në të ardhmen ta bëjë punën e vet dhe mos të arsyetohet me mungesë të rëntgenëve apo të materialeve tjera furnizuese. Pastaj duke iu referuar furnizimit me libra nëpër biblioteka, tha se është mirë që sivjet ka pasur donacione për furnizimin e bibliotekave me libra, por nuk ka pasur donacione nga komuna, pasi që komuna duhet të interesohet për furnizimin e bibliotekave me literaturë, dhe shtoi se ka qenë një donacion për gjimnazin, por shprehu dyshimet e tij nëse donacioni në fjalë është shfrytëzuar siç duhet, prandaj kërkoi që të formohet një komision nga komuna dhe të vlerësohet se donacioni prej 20.000 € a është shpenzuar për literaturë. Lidhur me fushën e bujqësisë, tha se në ndarjen e granteve për bujqësi ka raste kur p.sh. ferma, bagëti ose ndihma të tjera iu ipen njerëzve të cilët abuzojnë me to dhe shtoi se ka raste kur kanë marrë dy-tre krerë lopë, të cilat pas disa muajve i kanë shitur, kurse bujqit e vërtetë që duhet t'i kenë në pronësi ato nuk i kanë. Në fund, lidhur me çështjen e arsimit, tha se disa herë është debatuar për problemin e 6 shkollave të cilat janë pa emra, prandaj për të mos ndodhur turpi siç ka ndodhur me shkollën e mesme "Latif Berisha", pasi që shkollës në fjalë emri iu ka ndërruar me para, dëshmorë janë bërë me para, me interesa dhe me punësime, prandaj kërkoi që këto shkolla pa emra të emërtohen sa më shpejt që është e mundur, duke kërkuar që të mos preken emrat e shkollave tjera.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar fjalimit të S.Kadriut, tha se për të denoncuar gjithkush ka të drejtë, dhe shtoi se nuk është mirë të akuzohet

dikush, para se gjykata ta shpallë vendimin e vet. Kurse lidhur me higjienën në Komunën e Vushtrrisë, tha se në cilësinë e kryetarit të komunës nuk është i kënaqur me gjendjen aktuale, edhe pse është shumë më e mirë se sa në të kaluarën, dhe shtoi se janë shumë faktorë që ndikojnë në gjendjen e ambientit në qytet dhe në zonat rurale, dhe një ndër ta është kompania regjionale që menaxhon higjienën në komunë e cila nuk ka pajisje dhe staf të mjaftueshëm. Ndërsa lidhur me ndërtimet pa leje, tha se ka ndërtime pa leje, e në veçanti jashtë qytetit, dhe shtoi se ka bërë presion të madh në Drejtorinë për Inspektime që të ndërpriten ndërtimet pa leje. Gjithashtu tha se ndërtimet e shumta pa leje janë bërë menjëherë pas luftës, prandaj aktualisht ndërtimet pa leje janë shumë më pak në krahasim me fazën e pasluftës, dhe njoftoi për angazhimet e tij të vazhdueshme për ta ruajtur tokën e bukës. Po ashtu njoftoi se gjatë mandatit të tij në rrugën që të dërgon në fshatin Bukosh, vetëm një hapësirë është shndërruar në tokë ndërtimore vitin e kaluar edhe pse nuk është ndërtuar asnjë objekt në të, duke shtuar se ka intervenuar që as aty të mos ndërtohet asgjë. Mandej tha se kur ka pasur buxhet në dispozicion, Komuna e Vushtrrisë ka realizuar edhe rrënimet të ndërtimeve pa leje dhe përmendi rrënimet afër shtratit të lumit "Tërstena"; rrënim të aneksit të objektit në rr. "Dëshmorët e Kombit"; rrënimet edhe në fshatin Dobërlukë për të ndërtuar rrugë, në ato pjesë ku ka pas uzurpime të pronës publike, gjithashtu ka pas rrënim edhe në këtë vit për ndërtime pa leje. Në vazhdim duke iu referuar shpenzimeve për mallra dhe shërbime, tha se ka pas reduktime nga ministria përkatëse, prandaj janë krijuar probleme. Ndërkaq lidhur me shpenzimet gjyqësore, tha se Komunës së Vushtrrisë iu kanë marrë 50.000 €, prandaj dikush duhet të japë llogari, dhe me këtë çështje duhet të merret policia hetimore. Sa i përket rëntgenit, tha se Drejtoria për Shërbime Publike prej investimeve kapitale ka paraparë që në vitin 2011 të blejë një rëntgen dhe pasi që një kompani e ka fituar tenderin, por nuk e ka sjellë në afatin e caktuar, Drejtoria për Prokurim i ka dhënë edhe një afat shtesë, mirëpo edhe në afatin shtesë nuk e ka sjellur, prandaj ka dështuar prokurimi në fjalë në vitin e kaluar dhe si rezultat i këtij dështimi, në cilësinë e kryetarit të komunës e ka urdhëruar Drejtorinë për Prokurim së bashku me Zyrën Ligjore që ta padisin kompaninë në gjyq. Gjithashtu tha se do të interesohet se a ka pasur keqpërdorime gjatë furnizimit me libra nëpër biblioteka, si dhe a ka pasur keqpërdorime rreth ndarjes së bagëtive. Në fund lidhur me emërtimin e shkollave, tha se kërkesa për emërtimin e shkollave ka shkuar në ministri para shumë kohësh dhe shtoi se ka pas dhe akoma ka presione, pasi që secila familje e dëshmorëve dëshiron që me emrin e dëshmorit të saj të emërtohet ndonjë shkollë.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- njoftoi se mbledhja e KK-së ndërpritet për shkak të mungesës së kuorumit, derisa të ftohet vazhdimi i mbledhjes herën tjetër.

Mbledhja e KK-së në mungesë të kuorumit i ndërpreu punimet në orën 11:30.

Vazhdimi i mbledhjes së KK-së më 30.04.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:07**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Syla, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Mungoi: Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të medieve të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Ferit Idrizi - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- njoftoi se kjo mbledhje e KK-së është vazhdim i mbledhjes së ndërprerë të datës 05.04.2012, për shkak të mungesës së kuorumit.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- kërkoi dy minuta pauzë për një konsultim të shefave të grupeve asambleiste para se të fillojnë punimet e mbledhjes së KK-së.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së kërkon që mbledhja e KK-së të vazhdon aty ku ka mbetur.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së tha se rrjedhat e punës së kuvendit nuk janë duke shkuar normalisht, pasi që kryesuesi i kuvendit mban dy funksione: drejtor dhe kryesues, prandaj nuk mund t'i mban ato dy pozita në të njëjtën kohë dhe si rezultat i kësaj, kryesuesi është i obliguar që të jepë dorëheqje në bazë të ligjit në fuqi. Pastaj tha se Grupi parlamentar i AAK-së nuk lejon që në kuvend të ketë shkelje të ligjit dhe të merren vendime të paligjshme. Në fund kërkoi nga MAPL-ja që të jepë interpretimin juridik për çështjen në fjalë, sepse nëse vazhdohet me këtë kryesues, grupi parlamentar në fjalë do t'i braktis punimet e mbledhjes së KK-së.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- kërkoi një pauzë për konsultim me shefat e grupeve parlamentare.

Pas konsultimit të kryesuesit të kuvendit me shefat e grupeve parlamentare, fjalën e mori:

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se LDK-ja i ka shfaqur qëndrimet e veta më parë, mirëpo pas konsultës, LDK-ja dëshiron të kontribuojë për hir të interesit të qytetarëve.

Kështu që mbledhja e KK-së vazhdoi me këtë rend dite:

4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin e brendshëm të administratës dhe përshkrimin e vendeve të punës (shqyrtimi i parë).

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për entitetet publike dhe jopublike (shqyrtimi i parë).

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 01.Nr 17/12, të datës 26.01.2012.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim pa kompensim të pronës së paluajtshme në pronësitë komunës.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rrënimin e objektit të komunës, rregullimin e hapësirës dhëndërtimin e shtatores "Hasan Prishtina".

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e Bordit Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese urbane (për herë të dytë).

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin e Bordit Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese urbane.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për anulimin e Vendimit të kuvendit të komunës.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për kryerjen e shërbimeve me auto-merimangë.

13. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfrytëzim të mjeteve të fondit stimulues të USAID-DEMI, në shumën prej 25.000 \$.

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfrytëzim të mjeteve të fondit stimulues të USAID-DEMI, në shumën prej 45.000 \$.

4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për organizimin e brendshëm të administratës dhe përshkrimin e vendeve të punës (shqyrtimi i parë).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se draft-rregullorja në fjalë nuk ka pasur nevojë të vijë në kuvend për shqyrtim, pasi që nuk është në kompetencën e kuvendit që të aprovojë rregulloren në fjalë, prandaj kjo është kompetencë ekskluzive e kryetarit të komunës. Kurse për vendet identike të punës nëpër institucionet ku ka shërbyes civil, tha se nuk ka nevojë të bëhet përshkrim i vendit të punës, pasi që ato do t'i bëjë MAP-ja.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se në mesin e ligjeve që janë akute, e që duhet nxjerr nga institucionet qendrore është edhe Ligji për reformimin e administratës publike në Kosovë, pasi që është detyrë dhe obligim prioritar i caktuar nga Bashkimi Evropian, prandaj është e nevojshme që kjo çështje të shtyhet për një kohë të caktuar për t'u harmonizuar me normat, kriteret dhe dispozitat e Bashkimit Evropian.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, lidhur me përshkrimet e vendeve të punës për secilën kategori, i propozoi komisionit që përshkrimin në fjalë t'i shtohen edhe dy elemente: koeficienti dhe paga, pasi që në komunë të këto dy elemente ka pas dhe ka parregullsi.

Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit- tha se draft-rregullorja në fjalë është e hartuar në bazë të LVL-së, prandaj kuvendi duhet ta miratojë një rregullore, kurse përshkrimi i vendeve të punës është bërë për hir të transparencës.

Idriz Muzaqi, drejtor i Drejtorisë për Administratë- tha se vërejtja e I.Gashit është e qëndrueshme, pasi që draft-rregullorja në fjalë nuk është kompetencë e kuvendit, por është kompetencë e kryetarit të komunës dhe e drejtorëve të drejtorive për të përgatitur përshkrimin e vendeve të punës, mirëpo ka qenë kërkesë e kryetarit të komunës që të procedohet për kuvend.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- tha se nëse nuk është kompetencë e kuvendit, kërkoi që kuvendi të mos merret fare me këtë çështje.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi që të mos e shqyrtojë këtë pikë të rendit të ditës, pasi që është kompetencë ekskluzive e kryetarit të komunës.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për entitetet publike dhe jopublike (shqyrtimi i parë).

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar nenit 11 të draft-rregullores në fjalë, tha se kriter bazë duhet të jetë mendimi i specialistit të ranguar sipas sëmundjes që ka pacienti, pasi që organi kompetent duhet të vendosë kush ka prioritet dhe kujt duhet t'i ndihmohet.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për entitetet publike dhe jopublike në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskusimi publik fillon nga data 01.05.2012 dhe zgjat deri më 23.05.2012.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 01.Nr 17/12, të datës 26.01.2012.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim përmirësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.17/12, të datës 26.01.2012 për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara nga të hyrat vetanake, nga viti 2011 në vitin 2012.

Ndryshimet sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhen me sa vijon:

2.1 Shuma e mjeteve të bartura në programin e pagave dhe mëditjeve (kodi 111), në vend të shumës 31,978.08€, bëhet shuma 31,978.80 €;

2.2 Shuma e mjeteve të bartura – mallra dhe shërbime (kodi 130), në vend të shumës 133,977.39 €, bëhet shuma 125,025.19 €.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim pa kompensim të pronës së paluajtshme në pronësitë komunës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ipet në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim, në afat deri në 40 vjet toka në pronësi të komunës, pjesë e parcelës kadastrale P-70202053-00573-2, certifikata e pronësisë UL-70202053-00059, në sipërfaqe prej 900 m², ZK-Prelluzhë, MPB, Stacionit Policor në Vushtri, për vendosjen e kontejnerëve për nevojat e nënstacionit policor në Prelluzhë.

Vendosjen e kontejnerëve të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, do ta financojë Ministria e Punëve të Brendshme.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rrënimin e objektit të komunës, rregullimin e hapësirës dhendërtimin e shtatores “Hasan Prishtina”.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se është pozitive që kryetari i komunës si propozues e ka marrë parasysh propozimin e Grupit parlamentar të LDK-së. Pastaj pyeti se a duhet të ndryshohet edhe plani rregullativ, pasi që pjesa ku gjendet objekti i komunës është në kuadër të planit rregullativ urban, ku janë aprovuar tri plane, prandaj nëse hyn, duhet të ceket edhe ndryshimi dhe plotësimi i planit rregullativ.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se ndërtimi i shtatores së Hasan Prishtinës ka qenë kauzë edhe para luftës. Pastaj tha se ka qenë mirë që Drejtoria për Urbanizëm paraprakisht ta përgatitë një projekt-propozim, në mënyrë që të informohen anëtarët e kuvendit se si do të duket ky vend, pasi që të rrënohet ndërtesa e komunës, dhe a ka hapësirë të mjaftueshme për shtatoren e Hasan Prishtinës, sepse nëse nuk i plotëson konditat ky vend për shtatoren në fjalë, shtoi se vendi më i mirë është një pozicion ky është i dukshëm.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah propozim-vendimin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohet rrënimi i objektit të komunës, rregullimi i hapësirës dhe vendosja e shtatores “Hasan Prishtina” në rr. “Adem Jashari” nr.1, përkatësisht në pronën e komunës, e evidentuar në certifikatën e pronësisë UL-70202016-00045, me kulturë “shtëpi-ndërtesë”, në sipërfaqe prej 453 m² dhe “oborr” në sipërfaqe prej 1071 m², gjithsej 1524 m², si dhe P-70202016-00666-0, me kulturë “shtëpi-

ndërtesë”, në sipërfaqe 312 m², dhe “oborr” në sipërfaqe prej 87 m², gjithsej 399 m², në sipërfaqe të tërësishme 1923m².

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që në bashkëpunim me drejtoritë tjera kompetente të komunës të zbatojë procedurat ligjore për rrënimtë objektit të përcaktuara nënenin paraprak.

Mjetet financiare për rrënimin dhe rregullimin e hapësirës në fjalë do të planifikohen në buxhetin e vitit 2013.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e Bordit Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese urbane (për herë të dytë).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- kërkoi sqarim nga hartuesi nëse dikush nga anëtarët e bordit në fjalë është edhe anëtar i Komitetit Konsultativ për Urbanizëm, pasi që mund të jetë konflikt i interesit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim emërohet Bordi Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese urbane për qytetin dhe Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:

- *Menderes Ibra, kryetar i bordit;*
- *Ruzhdi Pllana, zv. kryetar;*
- *Arsim Gërxfhaliu, arkitekt;*
- *Musa Vatovci, arkitekt;*
- *Nexhmedin Melenica, inxh. i ndërtimtarisë;*
- *Bajram Xhafa, gjeodet;*
- *Bojana Artonovic.*

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin e Bordit Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese urbane.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim kompensohet puna e Bordit Këshillëdhënës në fjalë.

Bordi Këshillëdhënës për punën e tij do të kompensohet nga buxheti i komunës, në lartësi prej 50€ për çdo mbledhje.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për anulimin e Vendimit të kuvendit të komunës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01 Nr.162/11, dt. 24.02.2011, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim të tokës në pronësi të komunës, në afat prej 5 (pesë) viteve, me mundësi vazhdimi, e cila është pjesë e parcelës kadastrale P-70202043-00110-0, certifikata e pronësisë UL-70202043-00036, në sipërfaqe prej 1000 m², ZK-Nadakoc, për ndërtimin e një qendre edukuese bujqësore, për zhvillimin e aktiviteteve të IADK-së (Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës).

Anulimi i vendimit të cekur në nenin 1 të këtij vendimi bëhet pasi që marrësi në shfrytëzim të pronës komunale është tërhequr nga investimi i paraparë.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për kryerjen e shërbimeve me auto-merimangë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se është bërë një lëshim gjatë përpilimit të propozim-vendimit, pasi që nuk përmendet fare se e kujt është prona, prandaj kërkoi që të ceket se a është pronë e komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim caktohet lokacioni për kryerjen e shërbimeve me auto-merimangë (auto-park) në ngastrën kadastrale P-70202043-00110-2, me kulturë “oborr” me sipërfaqe prej 1000 m² dhe P-70202043-00110-3, me kulturë “oborr” me sipërfaqe prej 1234 m², me sipërfaqe të përgjithshme prej 2234 m², ZK-Nedakoc, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Kryerja e shërbimeve me auto-merimangë do të bëhet konform Rregullores për shërbimet e transportit me auto-merimangë në Komunën e Vushtrrisë.

13. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfrytëzim të mjeteve të fondit stimulues të USAID-DEMI, në shumën prej 25.000 \$.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se lllaptopët janë material shpenzues dhe anëtarët e kuvendit nuk e kanë obligim t'i kthejnë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 33 vota “për”, 1 “abstenim” vendosi me sa vijon:

Mjetet e fondit stimulues të USAID-DEMI në shumë prej 25.000 \$, të cilat në këtë vit iu janë ndarë Komunës së Vushtrrisë për transparencë për vitin 2011, destinohen për blerjen e lllaptopëve për anëtarët e kuvendit të komunës, dy zyrtarët e sekretarisë, si dhe blerjen e një aparati për skanim të materialeve, për nevojat e Sekretarisë së KK-së.

Në rast se shuma e mjeteve të cekura në nenin paraparak nuk është e mjaftueshme për destinimin e cekur, mjetet e nevojshme për këtë qëllim do të sigurohen nga buxheti i komunës.

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfrytëzim të mjeteve të fondit stimulues të USAID-DEMI, në shumën prej 45.000 \$.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Mjetet e fondit stimulues të USAID-DEMI në shumë prej 45.000 \$, të cilat në këtë vit iu janë ndarë Komunës së Vushtrrisë për performancë më të mirë të shërbimeve komunale, përkatësisht kategoria “rrugët, trotuarët, ndriçimi publik” destinohen për projektin “rregullimi i oborrit dhe ndërtimi i rrethojës të shkollës fillore dhe të mesme të ulët në fshatin Bukosh” (vlera e projektit: 28.182,04 €), dhe shkollës fillore në fshatin Smrekonicë (vlera e projektit: 19.802,75 €).

Në rast se shuma e mjeteve të cekura në nenin paraparak nuk është e mjaftueshme për destinimin e cekur, mjetet e nevojshme për këtë qëllim do të sigurohen nga buxheti i komunës.

Pas përfundimit të pikave të rendit të ditës, fjalën e mori:

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- njoftoi se hyn në fuqi dorëheqja e paraqitur më parë, dhe sot publikisht jep dorëheqje definitive nga pozita e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë. Në fund falënderoi anëtarët e kuvendit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin gjatë gjithë kësaj periudhe.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05.

Procesmbajtësi:

Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi

Lektore:

Vlora Krasniqi